



**VENDIM**

**Nr. 104 Datë 01.10.2013**

**PËR  
RINOVIMIN E LIÇENSËS SË SHOQËRISË “GEN – I TIRANA”  
SH.P.K ME NR. 73, SERIA FK08, NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT  
TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE, LËSHUAR ME  
VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 129, DATË  
02.12.2008**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 pika 1, nenit 45, pika 3 dhe 4 te Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “F”; 5, pika 1, germa “F”; 12; 13; 14 pika 1 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit te plote /te pjesshëm dhe rinovimit te liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, te ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.10.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “GEN – I Tirana” sh.p.k, për rinovimin e liçensës se furnizuesit te kualifikuar te energjisë elektrike dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “Gen – I Tirana”sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni specifik sipas tipit të liçensës (neni 9, pika 4/9, gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

### **Vendosi:**

- 1.** Rinovimin e licenses së shoqërisë “Gen – I Tirana” sh.p.k me Nr.73, Seria FK08, për kryerjen e aktivitetit Furnizuesit të Kualifikuar Energjisë Elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionereve nr.129, datë 02.12.2008, për një afat 5 (pesë) vjeçar.
- 2.** Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari në detyrë  
Shkëlqim Bozgo**